

20231793184

Në përputhje me 9-a, paragrafi 16 dhe nenin 56, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "numër 25/2000, 34/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 16/13, 91/2013, 187/2013, 43/2014, 44/2014, 97/2014, 112/2014, 113/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 98/2015, 129/2015, 150/2015, 154/2015, 192/2015, 217/2015, 27/2016, 37/2016, 120/2016, 142/2016 dhe 171/2017 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/2019, 77/2021, 285/2021 dhe 60/2023), Këshilli Drejtues i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 17.8.2023 mori

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LISTËS SË BARNAVE TË MBULUARA NGA FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I RMV-SË

Neni 1

Në "Lista e barnave të mbuluara nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 17/2015), në tekstin e mëtejme "Lista e barnave", në nenin 2, me titull "Lista A - Lista e barnave për kujdesin shëndetësor primar që mbulohen nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Maqedonisë", bëhen këto ndryshime dhe plotësime:

- te ATC-kodi C07AG02 – "Carvedilol** - tableta (O) JP", në kolonën 7, me titull "Regjimi i përshkrimit", para shenjës "RS" shtohet shenja "R", kurse përshkrimi i shenjës "RS/RSS – me rekomandim të kardiologut, internist" ndryshohet si në vijim: "R – barin e përshkruan mjeku i zgjedhur në përputhje me Udhëzimet për praktikën e mjekësisë së bazuar në dëshmi për menaxhimin e hipertensionit arterial në nivel të kujdesit shëndetësor primar, për këto shifra sipas klasifikimit MKB 10: I10, I11.0, I11.9, I12.0, I12.9, I13.0, I13.1, I13.2 I13.9, I15.0, I15.1, I15.2, I15.8 dhe I15.9, RS/RSS – me rekomandim të kardiologut, internist."

- te ATC-shifra C09CA01 – „Losartan** - tableta (O) JP", në kolonën 7, me titull "Regjimi i përshkrimit", para shenjës "RS" shtohet shenja "R", kurse përshkrimi i shenjës "RS/RSS – me rekomandim të mjekut specialist-internist" ndryshohet si në vijim: "R – bari e përshkruan mjeku i zgjedhur në përputhje me Udhëzimet për praktikën e mjekësisë së bazuar në dëshmi për menaxhimin e hipertensionit arterial në nivel të kujdesit shëndetësor primar, për këto shifra sipas klasifikimit MKB 10: I10, I11.0, I11.9, I12.0, I12.9, I13.0, I13.1, I13.2 I13.9, I15.0, I15.1, I15.2, I15.8 dhe I15.9, RS – me rekomandim të specialistit internist."

- te ATC-shifra C10AA – „Frenuesit e inhibitorëve të reduktazës HMGCoA (statinat)** FP (O) JP", në pjesën "***Indikacionet", pas pikës dh) shtohet një pikë e re e), e cila thotë: "Hipertensioni arterial, R – bari përshkruhet nga mjeku i zgjedhur në përputhje me Udhëzimet për praktikën e mjekësisë së bazuar në dëshmi për menaxhimin e hipertensionit arterial në nivelin e kujdesit shëndetësor primar, për këto shifra sipas klasifikimit MKB 10: I10, I11.0, I11.9, I12.0, I12.9, I13.0, I13.1, I13.2 I13.9, I15.0, I15.1, I15.2, I15.8 dhe I15.9".

- Te ATC – kodi H03AA01 – „Levothyroxine – tableta (O) JP", përshkrimi i shenjës "R" ndryshohet si në vijim: "Bari përshkruhet nga mjeku i zgjedhur në përputhje me Udhëzimet për praktikën e mjekësisë së bazuar në dëshmi për diagnostikimin dhe menaxhimin e hipotiroidizmit në nivelin e kujdesit shëndetësor primar, për këto shifra sipas klasifikimit MKB 10: E03.0, E03.1, E03.2, E03.3, E03.4, E03.5, E03.8 dhe E03.9".

- Te ATC – kodi R03BA05 – „Fluticasone - aerosol (Inh.) JP" në kolonën 7, me titull "Regjim i përshkrimit", para shenjës "RS" shtohet shenja "R", kurse përshkrimi i shenjës "RS – me rekomandim të mjekut specialist-internist, pediatër, pneumofitolog, specialist i mjekësisë së punës dhe specialist i imunologjisë klinike dhe alergologjisë" ndryshohet si në vijim: "R – bari

përshkruhet nga një mjeku i zgjedhur në përputhje me Udhëzimet për praktikën e mjekësisë së bazuar në dëshmi për trajtimin e pacientëve me astmë në nivelin e kujdesit shëndetësor primar, për këto shifra sipas klasifikimit МКВ 10: J45.0, J45.1, J45.8 dhe J45.9; RS - me rekomandimin e mjekut specialist internist, peditër, pneumofiziolog, specialist i mjekësisë së punës dhe specialist i imunologjisë klinike dhe alergologjisë.”

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq dhe do të botohet pas marrjes së pëlqimit të ministrit të Shëndetësisë.

Nr. 02-15653/3
17.8.2023
Shkup

Këshilli Drejtues
Zëvendëskryetari,
Дејан Николовски, d.v.